

VENDIM
Nr.477, datë 12.7.2006

**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË
PUNËMARRËSVE DHE TË PUNËDHËNËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 200 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës të jenë si më poshtë vijon:

- | | |
|---|------------------------|
| A. Organizatat e punëmarrësve me përfaqësues nga: | |
| a) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) | 4 anëtarë 4 kandidatë; |
| b) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH) | 4 anëtarë 4 kandidatë; |
| c) Unioni i Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë (USPSH) | 1 anëtar 1 kandidat; |
| ç) Federata Sindikale e Pavarur e Tregtisë Private, Bankave dhe Shërbimeve të Shqipërisë (FSTBSH) | 1 anëtar 1 kandidat. |
| B. Organizatat e punëdhënësve me përfaqësues nga: | |
| a) Këshilli i Organizatave të Punëdhënësve të Shqipërisë (KOPSH) | 2 anëtarë 2 kandidatë; |
| b) Bashkimi i Organizatave të Biznesit Shqiptar (BOBSH) | 2 anëtarë 2 kandidatë; |
| c) Konfederata e Këshillave të Organizatave të Punëdhënësve (KOP) | 2 anëtarë 2 kandidatë; |
| ç) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH) | 2 anëtarë 2 kandidatë; |
| d) Bashkimi i Industrialistëve dhe Investitorëve të Shqipërisë (BI&ISH) | 1 anëtar 1 kandidat; |
| dh) Konfederata e Industrialistëve të Shqipërisë (Konfindustria) | 1 anëtar 1 kandidat. |

2. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me propozimin e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve.

3. Vendimi nr.61, datë 23.1.2003 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha